

BIBLIOTEKA
E
8SH-1
R86
SHETIT
GJIROKASTËR

ne

VJERSHA

■ Nazmi Roli ■

891.985-1

286

S

NAZMI H. ROLI

Ne

(Djerska)

~~53950~~

30173

SHKURTORI I SHËNËT
SHËNËT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NE

Midis të gjithë ngjyrave të ylberit
Ne zgjodhëm më të dashurën:
Të kuqen.

Ndër të gjithë erërat e motit
Ne deshëm më të fortat:
Të Nëntorit.

Nga të gjithë rrugët e historisë
Ne ecëm në më t'vështirën:
Të revolucionit.

MUJO ULQINAKU

Gjithë trëndafilat e vendlindjes
Atë mbrëmje prilli kishin çelur,
Kur ti ike gurëve të rrugicës
Nga zëri i gruas i përcjellur.

Ende mirë me fëmijët s'u shmalle.
Ti u puthe sytë ndërsa flinin.
Atë mbrëmje prilli gjithë shtëpitë
E atdheut në zemër mërdhinin.

Atë ditë deti dallgë sillte,
Atë ditë deti sillte erë.
Topat heshtnin. Mbreti tutje ikte.
Si na erdhi, eh, ajo pranverë!

Ti e zbraze armën gjersa heshte.
Brigjeve të detit, mbylle sytë.
Përmbi trëndafila, atë mbrëmje
Si burim rodhi gjaku yt.

Gjithë trëndafilat e vendlindjes
Me gjakun tënd i skuqe atëhere...
Tek ti ne vijnë nga gjithë rrugicat,
Ne vijnë së bashku me pranverën.

Mirënjohjen tonë ty të sjellim,
Ndërsa er' e detit t'i kreh flokët
Trëndafilë prilli ty të hedhim,
Trëndafil i kuq i kësaj toke.

VAJZAT E FABRIKËS SË LETRËS

Kur sa vijnë e më të shkurtëra bëhen ditët e
vjeshtës.

Dhe si zogj vere nga larg duken mullarët,
Çdo ditë në mëngjez vajzat e fabrikës së letrës
Tek porta, nga të gjitha udhët,
vijnë si flutura të bardha.

Hyjnë në repartin e zbardhjes e agregate
Që e bardhë si zemra e tyre të dalë letra,
Që ne djemtë, moshatarët e tyre
Për dashuritë e tyre të reja,
Të shkruajmë më shumë vjersha.

P E I S A Z H

Mbrëmë gjithë natën ra dëbora e fundit e dimrit,
Mbi rrugët, lulishtet dhe çatitë e shtëpive.
Në mëngjez u duk sikur kish ardhur pranvera,
Sikur me lule të bardha
ishin rënduar degët e qershivë.

Vajzat pranë qershivë kaluan si një fllad i lehtë
Dhe ndjenë se pranvera ishte shumë afër,
Ashtu siç ndjejnë kur pas fëmijërisë së qetë
Vjen papritur mosha e kaltër.

Dhe i shkundën të gjithë qershitë me radhë,
Flutura të bardha u rrëzuan në tokë.
Dhe duke qeshur u futën në turnin e parë
Me petale të bardha dimri, ngatrruar flokët.

UNË PO NISEM SOT ME MOSHATARËT

Unë po nisem,
Kokën kam të qethur.
Sot me moshatarët shkoj ushtar.
Nënë e dashur, më përcill e qeshur,
Se me vete lotët s'mund t'i marr.

Motrat hidhen dhe më puthin fort
Dhe më thonë që ta ruaj trupin,
Veçse ti, baba, mbahesh i fortë,
Tek ma rreh kaq burrërisht supin.

Dhe ti, fqinj' e vogël e sykaltër,
Pse me gishta tinës i fsheh sytë?
Në s'ta shpreha dashurinë e pastër
Letrën time prite ndonjë ditë.

Unë po nisem sot me moshatarët,
Se i mbusha plot nëndëmbëdhjetë.
Për të mbrojtur grunjat, ullijt, arat,
Për t'ju mbrojtur juve, o të shtrenjtë.

* * *

Shpesh për ty më kap një mall i ëmbël
Dhe për viset e mia të qeta.
Larg më shumë ju dua ç'ju kam dashur,
Mallin tim e dërgoj në letra.

Ato vijnë si copra resh të bardha
Në horizont, kur skuqin perëndimet.
Ti, ndërsa era flokët do t'i shprishë,
Nëpër to do ndiesh dorën time.

MBAJ MEND

Mbaj mend në fëmijërinë time,
Një ditë,
Kur këmbët e zbathura
I përgjaka në gjakun e një atentati.
Mbaj mend babanë,
Që me urrejtjen dhe pushkën mbi shpinë,
Më puthi tri herë
Dhe doli malit për liri...
Mbaj mend nënën,
Që më shtërngonte në gji.
Që s'qante,
Që të mos qaja dhe unë,
Mbaj mend qytetin,
Që s'qante kur i vriteshin bijtë,
Por, si nëna mua,
Lagjet shtërngonte në gji...

PRANVERË 1945

Mungonin shumë lule atë pranverë.
Lulet-nga çizmet e huaja të shkelura.
Mungonin shtyllat, telat,
Nga duart e ilegalëve të prera,
Urat-në erë të hedhura.

Mungonin gjelbërimet atë pranverë të parë.
Shumë lugë në sofrë,
Shumë dashuri.
Mbi gropat e predhave nguleshin piketat e
bardha.
Atdheu
Për pranverat e ardhëshme shtronte gosti.

PARA INAUGURIMIT TË FABRIKËS SË QELQIT

Tani, që janë ndezur kaldajat dhe furrat e shkrirjes,
Për një çast harron se jemi në qendrën e dimrit.
Nesër te dera, në pragun e hyrjes,
Do të lidhin shiritin e inaugurimit.

Montatorët, që ikën në një vepër tjetër,
Si kujtim lanë makineritë
me përmasa të mëdha,
Nesër mbrëma elektrikistja
me sy të bukur, Shpresa,
Do i shtypë të gjitha butonet me radhë.

Nesër do rrotullohen rrypat e transmesioneve,
pulexhat
Në sytë e vajzave kavajase.

Një ditë në dasmën e elektrikistes Shpresa
Do e bëjmë urimin me gotat tona të kristalta.

Nga xhamat e dritareve me shkëlqime të pastra
Do e shohim ardhjen e pranverës.
Tani inaugurimi i ngjan një miku të ardhur,
Që pret t'i hapin derën.

DASHURI

Në fletëthirrjen telefonike shtërnguar në dorë
Ti më prite gjithë mbrëmjen në postë.
Unë s'erdha, duke shkelur mbi dëborë
Me ushtarët u nisa nëpër alarm e shqotë.

Dhe për ty mendoja duke ecur nëpër rrugë.
Ashtu siç mendoje ti në postë për mua.
Papritur vegimi yt m'u shfaq nëpër muzg.
Shkëlqimi i artë i flokëve të tua.

DUKE DËGJUAR VAÇE ZELËN

Gjer këtu, në kufirin e largët,
Vjen zëri i saj i ëmbël, i hollë,
Kënga bie mbi supe ushtarësh
Lehtë, lehtë si fjollë bore.

Kjo këngë gjithmonë na kujton majin,
Kur mollët lule të bardha çelin.
Fryj, ti këngë, në zemrën e ushtarit
Dhe ndize zemrën e tij si diell.

Ti erdhe nga larg nëpër tufane dhe erëra
Gjer këtu tek ne, në postë,
Ashtu si vjen në këto vise pranvera,
E dashur dhe e ngrohtë.

Erdhe, udhët duke i mbushur me buzëqeshje,
Që buronte nga zëri i saj si kristal.
Këtë këngë përshëndetjeje
Të dashurit e largët na e çonin si mall.

LIBRARI E SHKOLLËS
"DASHURITË"

30173

53950

KTHIMI I SKËNDERBEUT

Si flamur stuhie vinte Skënderbeu,
Gjithë udhët, gjithë udhët
Zgjatëshin drejt atdheut.

Agimi po binte mbi kodra. në pllaja,
E priste kjo tokë,
E priste Vojsava.

Si tufan po vinte,
Që rrugës nuk ndalet,
Si shpuzë ushtarësh pas e ndiqnin malet.

FËMIJËRIA.....

Në livadhet plot lulëkuqe të pranverës,
Mbasditeve të tejdukshme unë dilja prej
shtëpisë

Dhe ngrija balonin
Në drejtimin e kundërt të erës,
Në qiellin e kthjellët të fëmijërisë.

Sa e vogël dukej balona në atë qiell të madh, të
pastër!

Si një zog që në tokë nuk ulet më, kurrsesi.
Sa desha të të ul dhe një herë në livadhe,
O motiv i papërsëritshëm, fëmijëri!

ELEKTRIFIKIMI

Të dy bashkë do i ngulim shtyllat,
Telin do e shkrijmë në çdo skaj.
Unë do i shoh të ndezura dritat
Në kaltërsinë e syve të saj.

Peisazhi i dritave do të ndrisë,
Ti qerpikët do pulitësh ëmbël.
Si një fllad mbi degët e qershisë
Dashuria do më fryj' në zemër.

N Ë N A

Gjyshi im, që unë s'ja mbaj mend mirë zërin e
vrazhdë,
Nuk e linte kurrë nënën time të kalonte pragun e
derës.
Nëna ime vajzë, që nga mërzia dita i dukej javë.
Nuk e dinte kur vinin dhe iknin nga oborri hapat e
pranverës.

Nëna ime tani, çdo natë,
Motrat e mia nga turnet pret e përcjell,
Se nëna ime, që po zbardhet në flokë pak nga pak.
E di
Që në zemrat e tyre
lulet e kajsive të oborrit kanë çelur.

LULËKUQJA

Në fushën e sapokorrur
mbrëmja si zog u ul
Tek vërshëlleja për bukën një këngë popullore.
Nën këmbët e mia
kish çelur një lulëkuqe,
Si motiv i ditëve të verës në grurore.

Ndërsa mblidhja të gjith' kallinj të në duaj
Më dukej sikur i çfletaja verës të parin kapitull.
Me gishtat e lehtë të erës lulëkuqen e këputa
Për ta vënë në këtë vjershë si titull.

G O L E M I

Ditëve të bukura, ditëve të verës,
Shkon e vjen fishkëllima e trenit,
Dhe sjell njerëz, sa shumë njerëz!
Në brigjet e Golemit.

Pylli i pishave,
 rritur nën erën e detit,
Një shushurimë të gjelbërt nxjerr nga kraharori
Shtrirë në rërë,
 këtu aq afër të duket dielli,
Sa po të zgjatesh
 mund ta prekësh me dorë.

Punëtorët vijnë grumbuj-grumbuj të dielën
Për të larë djersën e turneve
 me shkumën e valëve

Në mbrëmjet e purpurta, pas perëndimit të
diellit,

Nga dashuria puthen

buzët e brigjeve dhe të vajzave

NESËR

Gjethet që këputen nga gjethet e vjeshtës dhe
rrëzohen në muzg
Era me vete i merr dhe i shpërndan rrugë më
rrugë.

Me peshën e rëndë të dashurisë, këtyre netëve,
Ne ikim

Duke shkelur mbi peisazhin e verdhë të fletëve.

Nesër, në këto rrugë,

dëbora e parë do të bjerë.

Ti do vish tek ne

Apo ne do vijmë sivjet tek ti, pranverë?

ÇDO TË SHTUNË

Çdo të shtunë në mbrëmje

Ty në stacionin e trenit të përcjell si
zakonisht

Ti do të ikësh.

Deri ditën e hënë

Akrepat e orës do i shtyj me gisht.

Flokët, buzët, sytë

Kanë diçka të përbashkët

me këtë mbrëmje pranverore

Megjithëse emri yt i brishtë

Rimon aq mirë me dëborën.

Së bashku me ty iku treni

Duke fishkëllyer këngën e lamtumirës.

Në zemrën time, çdo të shtunë, në mbrëmje,

Ti avitesh një kilometër më afër.

SËRISH

Shokut tim A. T.

Sërish në viset e dashura kam ardhë,
Ku plepat e udhës qëndrojnë ëndërrimtarë.
Si grigje qingjash të vrullshëm, të bardhë
Para më dolën fëmijët fshatarë.

Në duar mbanin gjithë lulet e fushës,
Që si ëndrra të freskëta në agim i mblodhën.
Gjoksin me fllad erërash ma mbushën,
Gëzimi në zemër si flutur m'u drodh.

Sikur ka rënë dëbora e parë
Në horizontin e fushës zbardhon pambuku.
Vajzat vjelin boçet e bardha
Ato për mua kanë çelur, më duket.

Si të mos ndjem i lumtur, i qeshur
Për njerëzit e fushës, për nxënësit e mi?
Me zemrën si boçe pambuku të çelur
Në gjirin tuaj sërishmi po vij.

PËRMBI SUPE M'I SHPËRNDAVE FLOKËT

Hëna doli si një kokërr pjepër
Nëpër shtigje resh, përmbi tokë.
Ti më erdhe lehtë si një ketër
Përmbi supe ma mbështete kokën.

Diçka ndjeva, dashuria jote
Përmbi gjoks më peshonte rëndë,
Sikur vjeshtë e artë, vjeshtë e ngrohtë,
Në atë çast më mbuloi si tëndë.

Dhe si ndrisnin sytë e tu të ëmbël.
Dhe si qeshnin sytë e tu të pastër.
Ty të frushullinte thellë në zemër
Dashuria ime e parë.

Hëna doli si një kokërr pjepër
Nëpër shtigje resh, përmbi tokë.
Ti më erdhe lehtë si një ketër.
Dhe mbi supe m'i shpërndave flokët.

MËNGJEZ NË KAVAJË

...Dhe dielli lindi.
Mëngjezi i ri
Natës ja gris çarçafin e vjetër, të zi,

Nga turni i tretë
Kthehen vajzat të veshura me pantallona
Filladi i freskët i puth faqet e skuqura.
Të njoma.

Dhe vajzat qeshin.
Mëngjezi i ri
Qytetit ja grisi çarçafin e zi.

DASHURIA E KALDAISTIT

Fytyra e kaldaistit është me pluhur qymyri
Dashuria e kaldaistit është si furrat e kaldajës:
gjithë prush.
Atë mbrëmje në zemrën e tij elektrikistja me flokë
të verdha hyri,
Atë mbrëmje në zemrën e tij ajo ndezi një llambë
të kuqe.
Ktheheshin nga turni pas të gjithë shokëve.
Tek supi i tij ajo u mbështet e sigurt, e heshtur.
Asaj një gjethe i kish mbetur mes flokëve,
Si kujtim i ditëve të fundit të vjeshtës.
Ai ngriti dorën të heqë kujtimin e vjeshtës nga
flokët,
Në atë çast neonët u ndezën në muzgun e Kavajës.
Atë mbrëmje, në zemrën e saj të ngrohtë
Ai derdhi gjithë prushin e nxehtë të kaldajës.

ALEKSANDËR MOISI

Nga kjo derë e vogël,
Nga kjo portë,

Hapat e tij u nisën nëpër botë.
Mbi këta gurë që shkelim ne tani
Ai shkeli në fëmijëri.

Dhe në një shtëmbë baltë piu
Gjithë krojet e vendlindjes Moisiu.

Skenave, mes duartrokitjesh
Dëgjonte zërin e largët të vendlindjes.

Kujtonte mbrëmjet që binin mbi ullinjtë
Siç i binin mbi supe lulet, duartrokitjet.

QIRAXHIU

*(Zim Merhorit, plakut që shoqëroi
Ismail Qemalin për në Vlorë).*

Tingëllinin zilet e karvanit
Duke shkuar udhës për në jug.
Hingëllinin kuajt,
Zjarre stanesh
Her'pas here shfaqeshin në muzg.

Ecnin nëpër natë kuajt rëndë,
Duke shkelur në udhët e vjeshtës.
Ai në vete murmuriste këngë
Mes vërshëllimës së mprehtë së erës.

Diç mendonte Ismail Qemali,
Burri plak me mjekrën si borë,
Zimi frerët i tërhiqte kalit
Duke çelur udhën për në Vlorë.

Po, e dinte qiraxhiu kavajas:
Ai burrë mendonte për atdhenë,
E dinte se ai plak i rrallë
Ishte vetë një copë mëmëdheu.

Si zog shkuan vitet një nga një
Përmbi tokë duke fluturuar.
Ata dhe kuajt s'janë më,
Nëpër tokë thundrat janë thelluar.

ZONJA ÇURRES

Mbi tufën e luleve labe, që nëna të vuri mbi lapi-
dar,

Dimri,

Nga gunat e reve shkund dëborën e parë.

Flokët e dëborës bien si petalet e bardha të baja-
meve,

Ty të kujtohen thirrjet e shokëve partizanë.

Larg është toka jote, labe,

Gjer këtu sa hapa bëre, sa hapa!

Dëborërat do bien përsëri e përsëri,

Por ti në zemra

s'do na thinjesh kurrsesi.

BABAI

Ai e kishte faqen të parruar.
Binte erë barut,
Erë malesh.
Rrobat nëpër flakë i ishin përcëlluar,
Gjoksin me dekorata plagësh.

Kish tre vjet pa më puthur asnjëherë.
Si flamur të kuq më ngrinte përpjetë,
Nga malet nuk më solli lodra fëminore,
Por lirinë,
Dhuratën më të shtrenjtë.

BAJONETAT

Rrjeshta të ngjeshur, ushtarë.
Këtë natë
Nënë dritën e rrufeve marshojmë ne.
Këto bajoneta që mbajmë nëpër duar
Rrufepritëset e tua janë,
Atdhe.

MOTIV

Kjo kashtë, që vjen nga hapësirat e arave,
Është bollëku i korrjeve të verës.
Si ngrihen mullarët, si ngrihen mullarët
Në sheshin e lëndës të fabrikës së letrës!

Ngriheshin dikur mullarët e verdhë
Si figura të arta poetësh lirikë,
Nga bujqit e mirë, që lopës dhe deles
Qumësht të ëmbël t'u kullonin gjinjtë.

Dhe erdhi kjo ditë e shvendosjes së tyre
Nga fushat e vjeshtës në turnet e natës.
Dhe presin radhën në reparte të hyjnë,
Buka e fabrikës, mullarët e kashtës.

KRISTINA, UNË DHE ERRËSIRA

Për miqësinë time me Kristinën folën shumë.
Kur ne ecim e nga pas dikush
na gjuanë me fjalë,
Kjo do të thotë se ndaj njëri-tjetrit
ne jemi më të sigurtë.

Kristina është motoriste e mirë, e aftë.
Flokët e saj kundërmojnë erë benzinë.
Një mbrëmje për shpikjen e saj ajo më foli gjatë
(Ashtu siç i shprehim dikujt dashurinë).

Unë, Kristinën, shoqen time të vjetër,
E përcjell në shtëpi pas turnit çdo natë,
Dhe ndodh që rrijmë ca tepër
Duke biseduar për shpikjen e saj.

Dhe kur i themi njëri-tjetrit «natën e mirë»
Duke i shtërnguar dorën fort shokut,
E dimë që dikush na përgjon në errësi,
E dimë që dikush do kollitet me zor.

E dimë që nesër ai do të thotë,
Se mbrëmë na ka parë përsëri
Duke u puthur afër shtëpisë së saj
tek porta,
Se ai hiperbolën e përdor mrrekulli.
Kur ta dëgjojmë këtë ne do të qeshim,
Se Kristina dhe unë e dimë fare mirë
Se ata që flasin,
një ditë do të heshtin
Dhe askush s'do na përgjojë më
në errësi.

NË MUZG

Më herët se pranvera sivjet erdhi stina e dritës.
Elektriçistët në shtyllat e fundit,
Montojnë izolatorët.
Në stanet që kundërmojnë aromë qumësht
nga kullotat e ditës
Vijnë kopetë e dhenve duke tundur këmborët.

Nga fushat,
ngarkuar me korrje kthehen qerret.
Fshati bie erë të këndshme buke.
Nga larg
Fshati ngjan me një fushë të gjerë,
Të mbjellë tejpertej me lulëkuqe.

DËSHMORI ADIL ALUSHI

Atë natë në portë s'i trokitën.
Në ëndrra ai flinte kur e ngritën.

S'e lanë që këmishën mirë ta vishte
Dhe flokët kaçurrel të krihte.

E morën për t'mos hedhur më trakte.
Ai la pa kryer shumë atentate.

S'qante nëna kur nazisti e godiste.
S'qante nëna, lotët i gëlltiste.

E dinte nëna se më s'do i vinte.
E dinte flokëbora, veç portën hapur linte. . . .

FLAMURI

Unë peisazhin soditja me pushkën hedhur mbi
krah

Kur agimi u shfaq në ekranin e horizontit,

I kuq, I kuq.

Në atë çast drejt agimit një shqiponjë u ngrit
fluturim.

Duke soditur peisazhin sikur pashë

Flamurin e kombit para betimit.

MBRËMJA E ÇLIRIMIT

Mijra lule në qiell çelin fishekzaret.
Sonte atdheu me dritë nëntori është mbushur.
Këtë mbrëmje na e sollën baballarët
Në ato ditë stuhie kur zbritën me pushkë.

Kjo është mbrëmja jonë e madhe e çlirimit.
Njerëzit në rrugë dhe sheshe hedhin valle.
Ne në zemër na kanë mbirë agimet.
Pranvera në zemër na ka çelur petale.

* * *

Erdhëm ne nga turnet, agregatet.
Ku gurgullojnë këngët e motorëve.
Këtu ku në pafundësi zgjatet
Reparti i artë i gruroreve.

Era lehtë i përkund kallijtë,
Fusha dridhet si një këngë e ëmbël.
Ne, ndërsa mbajmë në duar drapërinjtë
Grunjërat na shushërijnë në zemër.

Thellë, thellë na ka hyrë dielli.
Sot ne kemi ardhur në grurore,
Për të korrur flokët kaçurrele
Dhe motivet e arta fushore.

VAJZË USHTARE

Uniformën e ushtarit ti e veshë
Dhe me mua rende në alarme,
Ti që di aq ëmbël të buzëqeshësh
Sot me mua u bëre shoqe arme.

Vajz' e veshur me kapotë të leshtë
Dhe bustinën mbi flokët ngjyrë ari
Supeve ke ngjeshur bajonetën,
Përmbi shpinë ke çantën e ushtarit.

Dhe asgjë ty syrin nuk ta trëmb
Ndërsa ecën netëve në marshime.
Zemra e tokës rreh në zemrën tënde,
Për tokën zemrën e ke plot shqetësime.

* * *

Nën peshën e armëve dëbora kërcet, ngjishet.
Hapësira hapet si ëndërr ushtari,
e bardhë e pakufishme.

Ecim.

Sikur qafës së malit i ngjitet
Një pyll i dendur, i gjelbërt i lëvizshëm.

T U R N E T

Turnet që rotullohen rreth aksit të ditëve
I lënë njëra-tjetrës këngën e motorëve.

A s'janë këto tre turne,
Tre muajt e pranverës,
Që vërshejnë në Kavajë
gjelbërimin e klasës?

KTHIMI

Unë sot po kthehem nga kufiri
Me moshatarët, i çmobilizuar.
Pritmë, nënë e dashur, prite birin
Porsi dje, në nisje, e gëzuar.

Motrat do më presin krahëhapur
Do më hidhen me mall si dikur.
Dhe babai, dhe më shumë i plakur
Krahët do m'i rrahë porsi burrë.

Ti, që letrat t'i kam çuar shpesh.
E nga larg ta shpreha dashurinë,
Tek më sheh që erdha, buzëqeshjet
Si trëndafilë m'i hedh mbi makinë.

Unë po kthehem sot me moshatarët
Nga kufiri i çmobilizuar,
Po do mbetem përjetësisht ushtar
I kaltërsive me diell mbuluar.

PËRCJELLJE

Më përcjellin mua sot ushtar
Prindët, shokët,
fushat rreth e qark.
I fundit në përcjellje
Po ma tund shaminë.
Oxhaku i fabrikës që nga larg.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Ne	3
Mujo Ulqinaku	4
Vajzat e fabrikës së letrës	6
Peisazh	7
Unë po nisem sot me moshatarët	8
Shpesh për ty më kap një mall i ëmbël	10
Mbaj mend	11
Pranverë 1945	12
Para inaugurimit të fabrikës së qelqit	13
Dashuri	15
Duke dëgjuar Vaçe Zelën	16
Kthimi i Skënderbeut	18
Fëmijëria	19
Elektrifikimi	20
Nëna	21
Lulëkuqja	22
Golemi	23
Nesër	25
Çdo të shtunë	26
Sërish	27
Përmbi supe m'i shpërndave flokët	29
Mëngjez në Kavajë	31
Dashuria e kaldaistit	32

	Faqe
Aleksandër Moisiu	33
Qiraxhiu	34
Zonja Çurres	36
Babai	37
Bajonetat	38
Motiv	39
Kristina, unë dhe errësira	40
Në muzg	42
Dëshmori Adil Alushi	43
Flamuri	44
Mbrëmje e çlirimit	45
Erdhëm ne nga turnet, agregatet	46
Vajzë ushtarë	47
Nën peshën e armëve	48
Turnet	49
Kthimi	50
Përcjellje	52

Tirazhi 1.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-66

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970